



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR.1 sh.a

Date: 26.12.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Shërbime

“Mirëmbajtje dhe shërbime të ashensorëve në Qytetin Studenti dhe UBT”.

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “ Mirëmbajtje dhe shërbime të ashensorëve në Qytetin Studenti dhe UBT”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Shërbime për mirëmbajtjen e ashensorëve – 50750000-7

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,629,210 (një milion e gjashtëqindë e njëzetë e nëntë mijë e dyqindë e dhjetë) leke pa T.V.SH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Rezidenca Studentore Universitare Nr.1 sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; në vlerën **32,584.2** (tridhjetë e dy mijë e pesëqindë e tetëdhjetë e katë pikë dy) lekë.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Operatori ekonomik duhet të disponojë licencën zbatimi **NS 3-A** për montimin e impianteve ngritese dhe transportuese. Në përmbushje të kësaj kërkesë operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën e zbatimit të shoqërisë.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë kërkuar për të vërtetuar se operatori vepron sipas legjislacionit në fuqi dhe bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, gërma a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar, për tre vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros minimale vjetore për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit që prokurohet përkatësisht **651,684 (gjashtëqindë e pesëdhjetë e një mijë e gjashtëqindë e tetëdhjetë e katër)** lekë pa tvsh lëshuar nga autoriteti përkatës

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Vlera prej 40% e fondit limit të kërkuar është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar është bërë bazuar në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij.

2.3 Kapacitetet teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet te paraqese dëshmi për shërbime te mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (vlera e pritshme e kontratave) ose **325,842 (treqindë e njëzetë e pesë mijë e tetëqindë e dyzetë e dy)** lekë pa tvsh.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Ose

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara."

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qellim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

2.3.2 *Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar sipas standarteve ISO 9001-2015 për sistemin e menaxhimit të cilësisë, e vlefshme ose ekuivalente.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenin 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është e rëndësishme që operatorët të përmbushin kontratën me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, është standart që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Kjo çertifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë,: Është një standart ndërkombëtarë i dedikuar për sistemet e menaxhimit të cilësisë, i cili përshkruan një kornizë në përmirësimin e cilësisë për çdo organizatë që kërkon të ofrojë produkte dhe shërbime konform kërkesave dhe pritshmërisë së klientëve/palëve të interesuara në mënyrë më efektive të mundshme. Ndër të tjera ky standart harmonizohet me objektivat dhe planet e RSU NR.1 në rritjen gjithnjë e më shumë të cilësisë në punët e përditshme dhe përafrimin me procedurat e ngjashme me vendet e tjera të zhvilluara.

2.3.3 Operoret Ekonomike pjesëmarrës duhet te deklarojnë në fomrularin e vetedeklarimit se ka të punësuar minimalisht 1 punonjës të kualifikuar si më poshtë:

- **1 (një) punonjes Inxhinier Mekanik**

Ne cdo rast perpara publikimit te njoftimit të fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit, autoriteti enti kontraktor I kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari, qe te dorezoje dokumentat provuese per vetëdeklarimet ne formularin permbledhes te vetëdeklarimit si me poshte:

1. Kontrata e punes (e vlefshme)
2. Diplome

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Kërkesa e AK që OE duhet të ketë në stafin e tij 1 inxhinier mekanik është vendosur në funksion të realizimit të kontratës duke patur parasysh proceset përkatëse të shërbimit lidhur me mirëmbajtjen e ashensorëve dhe numrit te ashensoreve qe kane nevojje per sherbime

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Ashensorët e instaluar ne UBT dhe QYTET STUDENTI janë te prodhimeve te ndryshme nga ku rezulton se kemi 14 ashensore ne UBT dhe 4 ashensore ne QYTETIN STUDENTI. Nga keta ashensore kemi ne funksion 4 ne Qytetin Studenti dhe 4 ne UBT. Në UBT kemi 10 ashensore te cilet nuk jane ne perdorim por qe kerkojne te jene funksional dhe ti behen sherbimet e mirembajtjes mujore te domosdoshme.

Të dhenat teknike te ashensoreve jane pasqyruar ne specifikimet bashkengjitur.

Çdo muaj do te kryhen këto verifikime/shërbime:

- **Kontrolli i sistemit te frenimit;**
- **Kontrolli dhe regjistrimi i dyerve te kateve te kabinës;**
- **Kontrolli i kufizuesit te shpejtësisë;**
- **Kontrolli i qarqeve elektrike;**
- **Pastrim dhe vajtje komplet;**
- **Pastrim dhe larje kabine me solucion larës dhe dezinfektues.**

Për 8 ashensorët ne funksion janë parashikuar riparime dhe shërbime për një periudhe 12 mujore si me poshtë:

➤ Shërbim Mirëmbajtje Ashensori

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia
Ashensor			
1	F.V i patinave rrëshkitëse të dyerve të ashensorit	Copë	32
2	F.V rotelave varëse për dyert e ashensorit	Copë	32
3	F.V i çelësave në kabinë	Litra	40
4	F.V i termostatit të rezistencës	Copë	8
5	F.V i udhëzuesve të kundrapeshave të portave	Ml	40
6	F.V bateri	Copë	8
7	F.V patina rreshqitje per kabinen	Copë	32
8	F.V butona	Copë	32
9	F.V impulsore per ndalesa	Copë	32

10	F.V sensor per dyer	cope	8
11	Shërbim Periodik mujor	copë	8
12	Shërbim kontrolli dhe mirembajtje mujor	copë	10
13	<i>Kolaudimi periodik sipas V.K.M me nr.1056 date 23.12.2015 dy here ne vit</i>	cope	18

Për mirëmbajtjen e të gjithë ashensorëve është e nevojshme kryerja e shërbimeve si më poshtë:

Nr	Përshkrimi i punimeve dhe shërbimeve	Njësia	Sasia
1	<p>Kontroll dhe Shërbim periodik për:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Pjesët teknike dhe elektrike, ➤ Mekanizmin e dyerve të kateve dhe të kabinës, ➤ Mekanizmin e bllokuesit, ➤ Nivelin e vajit në rezervuar ,guarnicionet për ashensorët hidraulik, ➤ Pastrimin dhe vajisjen e pjesëve të ashensorit, ➤ Funksionalitetin e përgjithshëm. ➤ Kufizuesin e shpejtësisë ➤ Izolacionin e impiantit elektrik ➤ Tokëzimin 	Muaj	12

Specifikimet teknike të shërbimeve:

Nr	Shërbimi

1	Shpejtësia e riparimit të defekteve do të jetë brenda një dite nga njoftimi i defektit, për çdo shërbim të parashikuar në objektin e kontratës.
2	Kontrolli çdo muaj i sistemeve të ashensorëve dhe i gjithë parametrave që lidhen me mirëmbajtjen sipas specifikimeve teknike.
3	Rezultatet e kontrollit duhet të shënohen në librin e ashensorit i cili mbahet dhe firmoset nga përfaqësuesit e të dyja palëve.
4	Në këto shërbime përfshihet dhe vlera për materialet e pastrimit, vaji për shinat, grasoja, siguresa, llambat e sinjalizimit, kontaktet ndihmëse të releve të kuadrit të manovrës.

Operatori duhet te kete parasysh te kryhej cdo sherbim te nevojshem sipas standarteve CE per funksionimin dhe sigurin e ashensoreve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike hartohen nga struktura të specializuara për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për shërbimin objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Afatet e shërbimit: 12 Muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Nje nga detyrat funksionale të Drejtorisë së Shërbimeve Mbeshtetese është të kujdeset për mirëmbajtjen e e ashensoreve të Qytetit Studenti dhe UBT, Kamez. Ashensoret kërkojnë mirëmbajtje mujore për tu ardhur ne ndihmë Studenteve për një jetesë me cilesore.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **08.01.2025, ora 12:00**.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “Mirëmbajtje dhe shërbime të ashensorëve në Qytetin Studenti dhe UBT”, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.

Njesia e prokurimit